



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3734/ 4 prot

Datë 26.01.2026

V E N D I M

Nr. 137 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2026 me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-72922-12-18-2025, me objekt: *Blerje Kancelari për nevojat e Bashkisë Vorë*, dhe me fond limit 3,333,333 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G. Adresa: *Rruga “Fortuzi”, Nr. 66/1, Tiranë*.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vorë.
Adresa: *Rr. Unaza, Nr.2, Vorë*.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.12.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-72922-12-18-2025, me objekt: *Blerje Kancelari për nevojat e Bashkisë Vorë*, dhe me fond limit 3,333,333 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6228, datë 29.12.2025 dhe me nr. 3734/2025 prot., datë 29.12.2025 i operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit .

II.3. Me shkresën nr. 132 prot., datë 09.01.2026, protokolluar me tonën me Nr. 3734/1 datë. 12.01.2026 Autoriteti Kontraktor ka përcjellë në sistem Vendimin e KSHA-së. Referuar Vendimit mbi trajtimin e ankesës, KSHA ka vendosur mospranim të ankesës së operatorit ekonomik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon:

Te nderuar anetare te komisionit te shqyrtimit te ankesave. Paraqesim ankesen tone per DST si me poshte: 1- Kerkojme Heqjen e kriterit kualifikues ne piken 2.2.2 Shtojca 8 Ne piken 2.2.2 kerkohet:

2.2.2. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të çertifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

Kërkesa e mesipërme nuk është ne perputhje me LPP dhe aktet nenligjore në mbështetje të tij. Procedura objekt ankimit është procedurë E hapur e Thjeshtuar. Për këtë procedurë, LPP dhe VKM per RPP parashikon se Kriteret ekonomike financiare duhet te jene te thjeshtuara, dhe keto te fundit provohen me paraqitjen e vertetimit te xhiros per 3 vitet e fundit. (neni 55 pika 4 I VKM 285 date 19.05.2021)

Per sa me siper kerkojme heqjen e kesaj kerkese nga kriteret e kualifikimit.

III.1.1 Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST Shtojcën 8, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar , si dhe nenet 43 e 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

2.2.2. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të çertifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të*

shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

III.1.2. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti 7 kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.3. Në nenin 77, pikat 1/2/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1 Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) qendren ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

III.1.4. Referuar Nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 1 dhe pika 4, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Referuar Nenit 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4 i VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon

se: “[...]Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.[...]”

III.1.5. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë

kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënës i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në për zgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në rastin konkret, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, Komisioni vëren se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë sipas **pikës 2.2.2** *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilanci e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009....*

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se Autoriteti Kontraktor me kërkesa të tilla ndikon në uljen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke kufizuar pjesëmarrjen e tyre në këtë procedurë prokurimi, duke mos u dhënë mundësi operatorëve ekonomikë të cilët mund të zotërojnë kapacitetet e duhura për pjesëmarrje në procedurën objekt ankimi.

Paraqitje njëkohësisht e xhirove vjetore (kriteri 2.2.1.) dhe balanceve (2.2.2), për procedurat e hapura të thjeshtuara, kur legjislacioni parashikon që Autoritet Kontraktore të formulojnë kërkesa minimale në proporcion me llojin e procedurave, fondin limit dhe sasinë e mallrave për prokurim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se këto kërkesa nuk duhet të jenë kufizuese dhe se kriteri i vendosur 2.2.2. nuk është në proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikime të kriterëve kualifikuesë sa më sipër cituar, për të zgjeruar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.

Përsa argumentuar Komisioni, gjykon se përmbushja e kriterëve kualifikuesë, për sa i përket kapaciteteve ekonomiko financiare, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, të kriterit për *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilanci e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009,* duke rënduar pozitën e operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, referuar llojit të procedurës së prokurimit e konkretisht “procedurë e hapur e thjeshtuar”, apo edhe fondin limit, legjislacioni parashikon që autoritet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Në këtë kuptim, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në frymën e ligjit, duhet të marrë masa për të hequr kriterin 2.2.2. mbi

dorëzim të kopjeve të bilanceve të certifikuara, dhe që plotësimi i kapaciteteve ekonomiko financiare të mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qendron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi ndarjen në lote të procedurës së prokurimit me argumente:

[..] AK ka bashkuar ne kete procedure artikuj qe nuk kane karakteristika teknike te perbashketa. Artikujt 1-22 (Tонера per printera dhe fotokopje) nuk kane asnje karakteristike teknike te perbashket me artikujt 22-88 (kancelari) Ne nenin 42 te VKM 285, datë 19.05.2021 Ne rastin konkret, ka shume operatore ekonomike qe tregetojne tonera per printera por nuk tregetojne kancelari. Bashkimi I ketyre produkteve ne nje procedure te vetme, eshte jo vetem ne kundërshtim me piken 1 te VKM 285, por dhe ul ndjeshem konkurencen duke favorizuar operoret ekonomike qe tregetojne dhe kancelari dhe tonera njekohesisht.

Bashkimi ne te njejten procedure i produkteve qe nuk kane asnje karakteristike te perbashket teknike, ngushton ne menyre artificiale konkurencen, nuk siguron trajtium te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë Operoret ekonomike, nuk nxit pjesemarrjen ne procedure OE qe tregetojne vetem tonera, apo vetem kancelari, nuk siguron mireperdorimin e fondeve publike, pasi cmimi qe mund te marre per produktet nese i ndan ne lote me vete do te jete me i ulet sesa grupimi i tyre ne nje procedure me pjesemarrje me te ulet. Per sa me siper Kerkojme ndarjen e procedures se mesiperme ne 2 lote. Nje per tonera dhe nje per kancelari. [...]

III.2.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE dokumentin Preventiv dhe Specifikime Teknike si vijon:

Nr.	Emertimi I artikujve	Njesi	Sasia
1	Boje Ricoh IM C3003 Compatible Black Toner Cartridge,Ricoh IM C3003 Cyan Toner Cartridge, Ricoh IM C3003 Magenta Toner Cartridge, Ricoh IM C3003 Yellow Toner Cartridge ose ekuivalent	Set Color	10
2	Boje Ricoh Mp 307 Set Color ose ekuivalent	Set Color	10
3	Boje Ricoh IM C2004 ex Compatible Black Toner Cartridge,Ricoh IM Black , Cyan , Magenta, Yellow toner cartridges ose ekuivalent	Set Color	10
4	Boje fotokopje Toshiba\ e.studio T-2802E\ e-studio 2802AM/ ose ekuivalent	Copë	4
5	Bojë printeri HP MCP137 PNW ose ekuivalent	Copë	40
6	Boje Lexmark Mx 410 de, MS/MX 310/410/510/610 ose ekuivalent	Cope	5
7	Bojë printeri Kyocera ecosys M2135 DN TK-1150 ose ekuivalent	Copë	60
8	Bojë printer Ecosys Kyocera FS 6525 MFP TK-477 ose ekuivalent	Copë	15
9	Boje printer Kyocera Ecosys M2040 DN TK-1160 ose ekuivalent	Copë	10
10	Boje fotokopje Toshiba\ e.studio T-5018E\ e-studio 2518A/3018A ose ekuivalent	Copë	2

11	Boje HP Laser MFP 135A Black TONER ose ekuivalent	Copë	10
12	Bojë Brother HL-L 5100 DN Toner TN-2421 ose ekuivalent	Copë	15
13	Boje Brother DCP-L8410CDW Toner Cartridges ose ekuivalent	Set Color	10
14	Boje Brother DCP-L8410CDW Toner Cartridges (black) ose ekuivalent	Copë	5
15	Boje Lexmark MS 510 DN ose ekuivalent	Copë	15
16	Bojë printeri Kyocera ecosys M2035 DN TK-1140 ose ekuivalent	Copë	3
17	Boje printer Xerox WorkCenter 3025 ose ekuivalent	Copë	5
18	Boje printer Samsung M2026 MLT-D111S ose ekuivalent	Copë	5
19	Boje Samsung 2160 MLT-D101S ose ekuivalent	Cope	3
20	Boje HP Laser Jet 1320 ose ekuivalent	Cope	5
21	Bojë printer Epson L3276, 4 x 65ml individual ink bottles (Bk,C,Y,M) ose ekuivalent	Copë	10
22	Bojë Brother MFC- L2752DW Toner TN-2421 ose ekuivalent	Copë	20
23	Harddisk SSD 1 TB	Copë	4
24	USB 64 GB 3.0	Copë	10
25	Maus	Copë	30
26	Tastiera	Copë	30
27	Koka rrjeti RJ 45 ose ekuivalent	Copë	400
28	CD-RW 700 MB me kapak (pako me 10 copë).	pako	100
29	Leter A4 80gr/m ² -Permasa 210×297,Lemushmeria 80-130 ml/min-Amballazhimi mbeshetllje kunder lageshtires-Lageshtia 3.5-4.5%-Dukshmeria:>94%-Shkelqimi101-115%-Bardhesia 157-163	Risme	2000
30	Leter A3 80gr/m ² -Permasa 297mm x 420mm,Lemushmeria 80-130 ml/min-Amballazhimi mbeshetllje kunder lageshtires-Lageshtia 3.5-4.5%-Dukshmeria:>94%-Shkelqimi101-115%-Bardhesia 157-163	Risme	50
31	Kuti arkive	Copë	200
32	Stilolapsa min. 0.7 mm me boje blu	Copë	1500
33	Stilolapes me boje blu	Copë	500
34	Korrektor stilo min. 7 ml	Copë	50
35	Stika te verdha 76mm*76mm +/- 2%, me 500 flete	Copë	600
36	Stik i bardhe min. 20gr (Ngjites buzkuq)	Copë	200
37	Libra poste me 200 flete	Copë	5
38	Gershere per zyre jo me pak se 19 cm	Copë	50
39	Shirit ngjites transparent plastik/të vegjël	pako	30
40	Binder Clips 14-16 mm (kuti me 12 copë)	Kuti	100
41	Binder Clips 18-20 mm (kuti me 12 copë)	Kuti	50
42	Binder Clips 24-26 mm (kuti me 12 copë).	Kuti	30
43	Binder Clips 31-33 mm (kuti me 12 copë).	Kuti	30
44	Binder Clips 40-42 mm (kuti me 12 copë).	Kuti	30
45	Binder Clips 50-51 mm (kuti me 12 copë)	Kuti	30
46	Dosje kartoni e thjeshte min. 350gr/m ²	Copë	10000
47	Dosje me llastik , A4 , trashesia min. 450gr/m ²	Copë	600
48	Dosje me percina min.10cm (Dosje me percina jo me pak se 450 gr.)	Copë	200
49	Dosje me percina min. 15cm (Dosje kartoni me percina jo me pak se 450 gr.)	Copë	300
50	Dosje me qese 40	Copë	100
51	Dosje me qese 60	Copë	100
52	Dosje me qese 100	Copë	100
53	Tela per makine kapese 24/6	Kuti	500
54	Evidenciator me ngjyra te ndryshme	Copë	300
55	Kapak A4 per lidhje transparente	Copë	100
56	Priza 4 vendeshe jo me pak se 5 meter	Copë	20
57	Priza 6 vendeshe jo me pak se 5 meter	Cope	20
58	Libra magazine me min.400 flete	Cope	2
59	Zarfa te vegjel 11 x 23 cm +/- 1cm, me shirit per ngjitje te thjeshte	Copë	5000
60	Zarfa te vegjel 11 x 23 cm +/- 1cm, me shirit per ngjitje me dritare me qese	Copë	20 000

61	Zarfa te medha A4	Copë	3000
62	Zarfa A3	Copë	250
63	Heqëse teli	Copë	100
64	Meter shirit jo me pak se 50 m	Copë	4
65	Libra protokolli jo me pak se 200 flete	Copë	30
66	Lapsa te thjeshte	Copë	250
67	Qese A4 jo me pak se 50 micron	Pako	150
68	Mbajtëse kancelarie metalike	Copë	25
69	Mbajtëse dokumentash horizontal me 3 kate metalike	Copë	25
70	Kapëse aktesh (makine stapler 23/10)	Copë	5
71	Stilolaps të kuq	Copë	50
72	Meter shirit jo me pak se 20 m	Copë	4
73	Meter shirit jo me pak se 10 m	Copë	4
74	Meter shirit jo me pak se 5 m	Copë	4
75	Switch 24 porta	Copë	1
76	Switch 16 porta	Copë	4
77	Switch 8 porta	Copë	5
78	Ruter wireless	Copë	4
79	Tapete mausi	Copë	30
80	Blllok axhende ditore me permasa 17 x 24 cm +/- 2 %, me minimumin 300 faqe	Copë	10
81	Prehëse lapsash	Copë	10
82	Bateri per pult 1.5w	Copë	50
83	Liber udhëtimi me min. 25 udhëtime (me 3 kopje), format A4 , ngjyre e gjelber e lehte	Copë	10
84	Karton A4 ngjyre portokalli për licencat	Risme	4
85	Karton A4 ngjyre bezhë e lehtë për licencat	Risme	4
86	Karton A4 ngjyre të bardhe për licencat	Risme	4
87	Karton A4 ngjyre të gjelbër për licencat	Risme	4
88	Makinë llogaritëse tavoline me jo me pak se 12 shifra te shfaqura ne ekran, të ketë të gjitha funksionet ekonomike.	Copë	10

III.2.2. Referuar Nenit 2 “Qëllimi i ligjit” i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikon se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 “Parime të përgjithshme”, Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Neni 39 i ligjit “162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikon se:

Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet.

Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.

1. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

III.2.3. Në nenin 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorial*

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se ndarja ose jo e një kontrate në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: Llojin e mallrave, tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, kostot e ekzekutimit të kontratës dhe vështirësia teknike lidhur me ndarjen në lote, kohëzgjatja e paparashikuar etj. Gjithashtu, referuar nenit 39 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, autoriteti kontraktor në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit, në rastin konkret jemi në një procedurë nën kufirin e ulët monetar e megjithatë duke parë llojin/natyren e mallrave objekt

prokurimi dhe sasite për secilin lloj Komisioni në referim të DST, dokumentet preventiv, vëren se Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar vendimin e tij për mosndarje në lote të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton, se objekti i këtij prokurimi është “Blerje Kancelari për nevojat e Bashkisë Vorë” dhe në brendi të dokumenteve të procedurës gjendet Dokumenti preventiv, ku vëren, se në tabelën e mallrave janë listuar mallra të natyrave të ndryshme, kancelari si edhe bojra printeri, ku këto të fundit përbëjnë një numër dhe vlerë të konsiderueshme në preventivin e publikuar në DST.

Gjithashtu Komisioni vëren se Autoriteti kontraktor, në dokumentin Proces verbal mbi argumentimin e kriterëve për kualifikim nuk ka argumentuar faktin e ndarjes apo mos ndarjes në lote të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton, se ankimuesi kërkon ndarjen në lote të procedurës së prokurimit, duke mirëargumentuar pretendimet e tij “...ka OE që tregtojnë vetem tonera por nuk tregtojnë kanceleri dhe keta perjashtohen nga konkurimi pasi nuk mund të përbushin kriterin përpervoja të mëparshme edhe pse mund të ofertojnë me cmime të lira...”.

Komisioni, në analizë të dokumenteve të tenderit si edhe pretendimeve të ankimuesi konstaton se autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë blerje e një numri të konsiderueshëm bojra printeri cka përforcon faktin se këto mallra nuk janë të ngjashëm dhe duke qenë në numër të madh jo të gjithë operatorë që tregëtojnë materiale kancelarie kanë mundësi të ofrojnë mallrat objekt prokurimi duke plotësuar kërkesat e vendosura nga AK.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se ndarja ose jo e një kontrate në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, sasia dhe kostot e ekzekutimit të kontratës si edhe vështirësitë teknike lidhur me ndarjen në lote etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është blerje mallrash me natyrë të ndryshme dhe sasi të konsiderueshme për secilin lloj malli dhe ofertuesit, përfaqësues të biznesit të mesëm dhe të vogël nuk e kanë mundësinë e realizimit të kontratës.

Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se mosndarja në lote e procedurës së prokurimit në rastin konkret ku mallrat janë të natyrave të ndryshme dhe ku kostot e secilit grup janë në vlera afërsisht të njëjta, mosndarja në lote do të vështirësonte pozitat e operatorëve ekonomikë, përfaqësues të biznesit të mesëm dhe të vogël të cilët nuk kanë mundësi realizimi të kontratës, si rezultat do të ulte konkurrencën në radhët e operatorëve ekonomikë.

Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për ndarjen e procedurës në lote, në respekt të parimit të barazisë, proporcinalitetit, të nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-72922-12-18-2025, me objekt: Blerje Kancelari për nevojat e Bashkisë Vorë, dhe me fond limit 3,333,333 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit objekt ankimi.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe përpara ripublikimit të procedurës në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, të sjellë pranë KPP-së Setin e DST së me modifikimet përkatëse.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” ShPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

